



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1

Prenga përlotet pas humbjes, i kërkon fajle shqiptarëve! Joshua feston me flamur kuqezi, takon me radhë familjen e Kristjanit (VIDEO)

2

Kishte një muaj që mburrej se po përgatiste një sulm, kush është 21-vjeçari që mori para turmën me furgon në Paradën e Krenarisë në Berlin

3

Bien Facebook dhe Instagram, mijëra përdorues raportojnë probleme për t'u aksesuar në llogaritë e tyre

4

Zbulim i rrallë në Parkun Kombëtar të Llogarasë, eksploruesit gjejnë zgavrën 70 metra të thellë (FOTOT)

5

Furgoni përplas turmën në Paradën e Krenarisë në Berlin, 1 e vdekur, 16 të plagosur! Në kërkim 21-vjeçari me lidhje islamiste (VIDEO)


Kronikë

Sherri i Denis Tafilit në Durrës/ AMP nis hetimet për efektivin, i sekuestron armën! I dhunuari Gjuzi: Policin e kam parë disa herë më të kërkuarin e SPAK

Një ditë pas dhunës ndaj një qytetari në Shkallnur nga Denis Tafili, i kërkuar nga SPAK, asnjë gjurmë e tij nuk është gjetur. Polici, të cilit dyshohet se i doli zot mohon njohjen me anëtarin e grupit të Elvis Doçit, ndërsa i dhunuari pretendon se i ka parë disa herë bashkë. AMP i merr armën inspektorit Leonard Xhamollari dhe nis hetimet.

■ I kërkuari nga SPAK, Denis Tafili shfaqet në Durrës, godet me qytën e pistoletës një 36-vjeçar dhe largohet!

I kërkuari nga SPAK, Denis Tafili shfaqet në Durrës, godet me qytën e



Sokol Dema
25 Korrik, 11:19 | Përditesimi: 25 Korrik, 15:37

Share Post



Efektivi i policisë [Leonard Xhamollari](#), i cili dyshohet se të premten u bë **pjesë e konfliktit në Shkallnur të Durrësit**, mohon të ketë lidhje me Denis Tafilin, i shumëkërkuar nga SPAK si pjesë e grupit të Elvis Doçit, i njohur si Visi i Pojës.

Polici është ndihmës specialist në sallën e komandimit të Policisë së Durrësit, ndërsa pas ngjarjes Agjencia e Mbikëqyrjes policore i sekuestroi armën e shërbimit. Ndryshe ka pretenduar në dëshminë e tij para hetuesve, [Edison Gjuzi](#), personi i dhunuar me qytën e pistoletës nga Tafili. Ai ka dëshmuar se e ka parë efektivin Xhamollari disa herë nën shoqërinë e Tafilit dhe personit të tretë që e dhunuan.

Dy dëshmitë janë të kundërta me njëra-tjetrën, ndaj AMP po verifikon në detaje ngjarjen, përfshirë edhe pamjet e kamerave të sigurisë për të parë në çfarë kushtesh paraqitet polici. Nëse vërtetohet se ai ka ndihmuar Tafilin dhe personin tjetër për të dhunuar Edison Gjuzin, siç paraprakisht dyshohet, pozita e tij para ligjit rëndohet ndjeshëm, një efektiv policie nën shoqërinë e një të shumëkërkuari të kërkuar nga SPAK.

LEXO EDHE:
I kërkuari nga SPAK, Denis Tafili shfaqet në Durrës, godet me qytën e pistoletës një 36-vjeçar dhe largohet! AMP nis hetimet për policin e përfshirë në sherr, ku pati dhe të shtëna

Konflikti nisi rreth orës 15:00, kur dyshohet se Gjuzi u qëllua nga [Denis Tafili](#) dhe një tjetër 27-vjeçar, të dy nga Shkallnuri. Menjëherë më pas u larguan me një makinë. Pavarësisht postbloqeve të ngritura nga policia, dyshja nuk është arritur të kapet.

Në maj të këtij viti SPAK mbylli hetimet për grupin e Elvis Doçit, pjesë e të cilit është vetë Tafili, i shpallur në kërkim me masë sigurie “arrest në burg”. Grupi u godit një vit më parë falë operacionit të përbashkët me autoritetet italiane, “Ura”. Ndaj 24 anëtarëve të grupit rëndojnë akuzat për trafik ndërkombëtar kokaine, grup të strukturuar kriminal dhe pastrim parash. Gjatë ekzekutimit të operacionit u sekuestruan edhe 4 milionë euro CASH dhe 12 milionë euro pasuri, kryesisht prona. Në sekuestro u vendosën 2 kompani ndërtimi, 4 restorante luksoze, 1 agjenci imobiliare, 1 televizion në Vlorë, të dyshuara se ishin financuar nga trafiku ndërkombëtar i drogës. Ndërkohë, në vendin fqinj sekuestruan 9 apartamente, 4 kompani, 7 llogari bankare e 3 makina.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.

K.M/SI.E./Shqiptarja.com

TAG: [denis tafili](#) [Leonard Xhamollari](#) [Edison Gjuzi](#)

Komento

Komente

© Ndalohe

Sondazhi i ditës:
Epoka e re e kërkesave, mendoni se reagimi i Ramës për protestat është i duhuri?

24 Korrik, 13:38

Po

Jo

Nuk e di

Lajme të tjera



Trafikuan mbi 3.6 ton kokainë dhe kanabis/ SPAK mbyll hetimet për grupin e Visit të Pojës, 24 anëtarë në gjykim! Ju sekuestruan 4 mln euro cash dhe 12 mln euro prona (EMRAT)

12 Maj, 16:25



Trafikuan 1.3 tonë kokainë, Italia godet sërish grupin e Visit të Pojës, 24 masa sigurie! SPAK arreston oficerin e Antiterrorit, sekuestrohet 12 mln € drogë (EMRAT+VIDEO)

27 Nëntor 2025, 10:36



